

AKT - THEMELIMI

I

SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “YOUTH STARTUP” Sh.p.k.

Ne bazeteligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dheatij nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me vullnetin e tyre te lire, të shprehur nënshkrimin e këtij Akti, sot me date 06/03/2023,

- Rigels Lulo lindur në Gjirokastrë me datën 02.04.1984 dhe banues në Tiranë, Rr. Ate Zef Pellunbi, njësia administrative nr. 11 Pll nord construction . Kartë identiteti numër **I40402093G**.
- Alvin Qehaja lindur në Tiranë, me datën 11.06.2002 dhe banues në Tiranë, Rr. Mark Bajraktari, Laprake. Kartë identiteti numër **K20611041G**.
- Silvia Capodicasa lindur në Tiranë, me datën 21.02.2002 dhe banues në Tiranë, Rr.Sheshi Gjeneral San Martin, njësia administrative nr. 5. Kartë identiteti numër **K25221045R**.
- Gabriel Capodicasa lindur në Tiranë, me datën 19.08.2005 dhe banues në Tiranë, Rr.Sheshi Gjeneral San Martin, njësia administrative nr. 5. Kartë identiteti numër **K50819055C**.

deklarojne se dëshirojnë te nënshkruajnë këtë Akt Themelimi përkrijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “YOUTH STARTUP” shpk. Aktivitetit i shoqërisë do tërregullohet nga Akti i Themelimit, Statuti dhe legjislacioni shqiptar për shoqëritë tregtare.

NENI 1

Formohet shoqëria e emertuar “YOUTH STARTUP” shpk me themelues: Rigels Lulo, Alvin Qehaja, Silvia Capodicasa dhe Gabriel Capodicasa

NENI 2


Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (Shpk) dhe do të përballojë humbjet deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqëria e ka seline e saj në rrugën, Margarita Tutulani P 5/1 SH 2 AP 3 Tiranë. Ajo mund të hap dhe seli të tjera të treta, degë e filiale, përfaqesi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

NENI 4

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me periudhe kohore pa limit.



NENI 5

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë do të jetë

- Prodhim i materialit reklamues: video, spot, postera, roll-up, fletëpalosie, broshurë, kartëvizita.
- Portali i internetit për reklamim dhe informacion
- Shitja e suplementeve dhe produkteve natyrale
- Inkubatorët e startup-eve inovative mes të rinjve dhe ndihmojnë në krijimin e vendeve të punës
- Agjensi shërbimi
- Promovimi i turizmit në fusha të ndryshme.
- Shitja e produkteve online.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë për behet në të holla me një vlerë prej 100.000 (njëqindmije) lekë i cili është i ndarë në katër kuota sipas kontributeve të ortakëve:

- një kuote është me 25 përqind me vlerë 25.000 leke zotërohet nga Rigels Lulo;
- një kuote është me 25 përqind me vlerë 25.000 leke zotërohet nga Alvin Qehaja;
- një kuote është me 25 përqind me vlerë 25.000 leke zotërohet nga Silvia Capodicasa;
- një kuote është me 25 përqind me vlerë 25.000 leke zotërohet nga Gabriel Capodicasa;

NENI 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të Asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortakët mund t'u shesin të katërve kuotat e kapitalit pjesërisht ose tërësisht të parashikuara nga ligji nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

NENI 9

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje "YOUTH STARTUP" SHPK - Tiranë, Shqipëri".

NENI 10


Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

NENI 11

Në castin e krijimit, emërohet nga Asambleja e Ortakëve si Administrator i shoqërisë "YOUTH STARTUP" SHPK, për mandatin e parë pesë vjeçar (i rinovueshëm) Rigels Lulo.



NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në baze të kriterëve të caktuara nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale.

NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim të ortakëve të saj duhet shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme sipas përqindjeve të përshkruara në nenin 6, mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet e të jetë hequr fondi i rezervës ligjore.

NENI 14


Akti u perpilua në katër kopje me fuqi të barabartë secila, për t'u depozituar në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.

ORTAKET

Rigels LULO



Alvin QEHAJA



Silvia CAPODICASA

Silvia Capodicasa



Gabriel CAPODICASA

Gabriel Capodicasa

